



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:086066

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05861984

**2022:086067**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Nj.Sh. nga fsh... K. Ferizaj, me numër personal ... dhe M.Sh. nga fsh.... K. Ferizaj me numër personal ....., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Av. Burhan Qosa avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "P.", me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga L.S., me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 11,493,41€, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqës, me datë 26.06.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësve Nj. dhe M.Sh. të dy nga fsh.... K. Ferizaj, ashtu që: **DETYROHET** e paditura K.S "P." me seli në Prishtinë, që paditësve t'ua kompensoj dëmin lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 06.01.2022, rreth orës 21:55h, në fsh. ..., K. Ferizaj dhe atë:

**a.** Paditësit Nj.Sh. të kompensohet me sa vijon:

-Në emër të dëmit jo material:

-Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....1,800 €

-Për frikën e përjetuar, shumën prej.....1,000€

-Në emër të dëmit material:

-Për ndihmën e personit të tretë dhe kujdesin e huaj, për 15 ditë, për shumën prej.....250,00€

-Për ushqim të përforcuar, për 21 ditë, shumën prej.....210,00€

**b.** Për paditësen M.Sh. të kompensohet me sa vijon:

-Në emër të dëmit jo material:

-Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....1,500 €

- Për frikën e përjetuar, shumën prej.....1,000€  
-Në emër të dëmit material:  
-Për ndihmën e personit të tretë dhe kujdesin e huaj, për 10 ditë, për shumën prej.....100,00€ -  
Për ushqim të përforcuar, për 14 ditë, shumën prej.....140,00€

**c. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e shërimit, për të dy paditësit (sipas faturave), gjykohet në shumën prej 390.71€ ndërsa refuzohet pjesa tjetër përtej shumës së gjykuar e deri në shumën prej 1403.41€ së kërkuar në total nga paditësit.

Gjithsej shuma për kompensim: 6390,71€ (gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë euro e shtatëdhjetë e një cent), së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.28.04.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

- II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumave të gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: Paditësi Nj.Sh. për dhimbjet trupore – fizike në shumën prej 2,000€; për frikën e përjetuar në shumën prej 500€, për paditësen M.Sh. për dhimbjet trupore – fizike në shumën prej 1,000€; për frikën e përjetuar në shumën prej 500€.
- III. DETYROHET** e paditura K.S “P.” me seli në Prishtinë, që paditësve, Nj. dhe M.Sh. të dy nga fsh.... K. Ferizaj, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore sipas suksesit të treguar në këtë procedurë t’ua paguajë shumën e përgjithshme prej 1467.6€ (njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë cent) dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së gjykuar refuzohet si e pabazuar.

### **A r s y e t i m**

Paditësit, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Burhan Qosa nga Ferizaj, pranë kësaj gjykate me datë 28.04.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti

kompensimin e dëmit material dhe jo material. Në padi ndër tjera pretendohet se më datë 06/01/2022, rreth orës 21:55h, ka ndodhur një aksident trafiku si pasojë e fajit të vozitësit E.Sh., i cili ishte duke e drejtuar veturën e tipit Audi A3 (Vetura A) me ngjyrë të bardhë, me targa regjistrimi ... në rrugën Ferizaj-Gjilan përkatësisht me të ardhur në rrugën hyrëse për në fsh. ..., duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes dhe nga pakujdesia godet me pjesën e mbrapa të veturës së paditësit Nj.Sh. me këtë rast bënë që të shkëputet rrota e mbrapme e veturës së paditësit (Vetura B) dhe bënë që të humbë kontrollin e automjetit paditësi, ku pastaj vetura e paditësit godet në pjesën e përparme veturën tjetër (Vetura C) e cila po lëvizte në pjesën ballore të veturës së paditësit. Si rezultat i këtij aksidenti paditësve u shkaktohen lëndime trupore të rënda, të cilat janë përcjellë me dhimbje të rënda fizike, frikë të madhe. Po ashtu paditësve u janë shkakuar shpenzime të mëdha të mjekimit duke përfshirë këtu edhe shpenzimet e transportit, ndihmën dhe kujdesin nga personat e familjes dhe natyrisht edhe nevojën e përdorimit të ushqimit të përforcuar. Në seancën përgatitore, po ashtu të shqyrtimit kryesor dhe në fjalë përfundimtare paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë theksuar se qëndrojnë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se meqenëse kontestuese mbetet vetëm lartësia e kërkesëpadisë, propozojnë nxjerrjen e ekspertizës mjekësore me ekspertë nga lëmi i ortopedisë dhe ekspert të psikiatrisë në mënyrë që të njëjtit të japin mendimin e tyre lidhur me llojin dhe intensitetin e lëndimeve të pësuar. Më datë 08/02/2024 i autorizuari i paditësve ka paraqitur parashtrësë me të cilën ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe të detyrohet e paditura që paditësve t'ia paguajë shumat si në vijim: Për paditësin Nj.Sh. për dëmin jo material: Në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 3,800 €; për frikë shumë prej 1,500 €; për dëmin material: Në emër të ndihmës së personit të tretë shumë prej 250 €; në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 210.00 €, në emër të shpenzimeve të shërimit për rehabilitim shumë prej 618.89 €, në shumë të përgjithshme prej 6,378.89 €, të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim tek e paditura, e deri në pagesën përfundimtare. Për paditësen M.Sh. për dëmin jo material: Në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 2,500 €; për frikë shumë prej 1,500 €; për dëmin material: Në emër të ndihmës së personit të tretë shumë prej 160 €; në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 170.00 €, në emër të shpenzimeve të shërimit për rehabilitim shumë prej 784,52€, në shumë të përgjithshme prej 5,114.52 €, të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim tek e paditura, e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancën përgatitore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor dhe në fjalë përfundimtare përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se në këtë çështje juridike e konteston padinë vetëm për nga lartësia e saj, pasi që e paditura, paditësve u ka ofruar shumat për kompensim si në përgjigje të dërguar por që ata nuk e kanë pranuar. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se lidhur me ekspertizën nga lëmi i ortopedisë nuk ka vërejtje, meqenëse me anë të kësaj ekspertize janë vërtetuar plotësisht pretendimet e të paditurës se te paditësit janë manifestuar lëndimet të lehta trupore, e po ashtu edhe në ekspertizën nga lëmi i psikiatrisë nuk ka pasur vërejtje lidhur me ekspertizën. Meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me kategori të dëmit të cilat konsiderohen si lëndime të lehta, andaj edhe e ka kundërshtuar parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë, përkatësisht dokumentet mjekësore të bashkangjitura meqenëse të njëjtat sipas vlerësimit të censorëve mjekësor të kompanisë nuk kanë lidhje kauzale me aksidentin, ku edhe një fakt i tillë është theksuar edhe në faqen e fundit të ekspertizës nga lëmi i ortopedisë. Andaj e paditura e kundërshton lartësinë e kërkesëpadisë sepse çmimet në të janë tejet të larta dhe e tejkalojnë qëllimin e kompensimit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë procedurën e administrimit të provave, sipas propozimit të palëve ndërgjyqës ka administruar provat vijuese: Kërkesë e datës 28.02.2022, për shpërblimin e demit; Raporti i aksidentit nr. 2022-CFT-13, i datës 06.01.2022 së bashku me raportin e policit hetues dhe skicën nga vendi i ngjarjes të noterizuara; Raport i qendrës emergjente i datës 07.01.2021 për Nj.Sh.; Raport i qendrës emergjente i datës 06.01.2021 për M.Sh.; Raport specialistik ortopedik i datës 17.09.2022 për Nj.Sh.; Dëftese me numër ... në shumë prej 8 €; Raporti specialistik për Nj.Sh. i datës 28.01.2022 nga dr. A.A.; Incizimi i datës 28.01.2022 i ORL- Shëndeti për Nj.Sh.; Raport specialistik ortopedik i datës 01.02.2022, për Nj.Sh.; Udhëzim për mjekim spitalor i datës 18.02.2022 si dhe cd incizimi; Urdhëresë për dhënien e terapisë parenterave i datës 18.02.2022; Njoftim i të paditurës për kompensimin e demit; Ekspertiza Ortopedike e ekspertit Dr H.G. dhe plotësimi i saj i datës 13/3/2024 në lidhje me faturat si dhe ekspertiza e ekspertit psikiatër Dr. F.G. dhe provat e bashkangjitura parashtresës për plotësimin e padisë.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura në tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në mes të palëve ndërgjyqës, nuk rezulton të jetë kontestues baza juridike e padisë. Po ashtu nuk rezulton të jetë kontestues fakti se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar tek e paditura. Me leximin e raportit të policit hetues dhe përgjigjes në padi nga e paditura, është vërtetuar se deri te ky aksident i komunikacionit rrugor ka ardhur si shkak i lëshimeve primare të shoferit të automjetit A (Audi A3) me targa: .... me veprimet e tij - vozitje e pakujdesshme-moskujdes gjatë lëvizjes në rrugën Gjilan-Ferizaj me të ardhur në rrugën hyrëse për në fsh. ..., duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes dhe nga pakujdesia godet me pjesën e mbrapa të veturës së paditësit Nj.Sh. me këtë rast bënë që të shkëputet rrota e mbrapme e veturës së paditësit (Vetura B) dhe bënë që të humbë kontrollin e automjetit paditësi, ku pastaj vetura e paditësit godet në pjesën anësore të anës së majtë veturën tjetër (Vetura C) e cila po lëvizte në pjesën ballore të veturës së paditësit. Pra nga kjo rezulton se përgjegjësia primare në shkaktimin e këtij aksidenti është tek drejtuesi i automjetit (Vetura A) e cila ka qenë i siguruar tek e paditura. Duke u bazuar në këtë gjendje faktike kemi të bëjmë me përgjegjësi të plotë dhe kjo përgjegjësi sipas vlerësimit të kësaj gjykate për të paditurën si përgjegjëse primare është vlerësuar me përgjegjësi të plotë dhe mbi këtë bazë është vendosur.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqës mbetet çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, me ç' rast pala e paditur pretendon se shumata e kërkuara nga ana e palës paditëse nuk i përgjigjen vëllimit të dëmit të pësuar për paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit.

Nga dokumentacioni mjekësor bashkangjitur me padi dhe të shqyrtuara nga ekspertët mjekësor të caktuar nga gjykata sipas listës së ekspertëve të licencuar të KGJK vërtetohet se paditësi Nj.Sh. si pasojë e aksidentit kishte pësuar lëndime të lehta trupore: Përdredhje të qafës, shtypje e dërmishje të kraharorit dhe belokerbishtit; Çrregullim i stresit akut; Zhurmë në të dy veshët; Rrjedhje akute nga veshi i mesëm; Rrjedhje akute e veshit të djathtë, audiogrami-rënie 33.7% veshi i djathtë.

Nga fletë lëshimet e lëshuara nga Qendra për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim – Banja e K., vërtetohet se paditësi Nj.Sh. i është nënshtruar tretmanit rehabilitues në këtë qendër dhe atë në periudhë nga dt.09/06/2022 deri me datë 14/06/2022. Nga faturat e lëshuara nga Qendra për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim – Banja e K., me nr. ... e dt.09.06.22, vërtetohet se për shërbimet e ofruara pranë kësaj qendre, detyrimi për pagesë për paditësin ka konsistuar në

shumën e përgjithshme prej 125€ në emër të paditësit Nj.Sh., njëjtë edhe për paditësen M.Sh. sipas faturës nr. ..., të dt. 09.06.22.

Po ashtu edhe nga dokumentacioni mjekësor bashkangjitur me padi dhe të shqyrtuara nga ekspertët mjekësor të caktuar nga gjykata vërtetohet se paditësi tjetër M.Sh. si pasojë e aksidentit kishte pësuar lëndime të lehta trupore: Përdredhje të qafës, shtypje e dermishje e qafës. Rrallim kockor i përgjithshëm; Hipertension arterial primar; Osteopeni-rrallim i kalciumit në kocka; Hipertension arterial. Koronarografi-pa ndryshime të rëndësishme.

Sipas propozimit të autorizuarit të palëve paditëse, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjekësore dhe atë me ekspertë nga lëmi i ortopedisë dhe e psikiatrisë, me ç' rast për ekspertë me aktvendim janë caktuar Dr. H.g. - Ortoped - traumatolog dhe Dr. F.G. – Psikiatër në të cilin aktvendim i janë përcaktuar edhe detyrat e ekspertimit. Ekspertët e lartcekur kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim me dt.13.12.2023 dhe 15.12.2023. Në mendimin e dhënë, ekspertët sipas konsultimit të raporteve mjekësore të bashkangjitura me padinë dhe nga ekzaminimi klinik i të aksidentuarve përkatësisht paditësve dhe nga përvoja e tyre profesionale kanë arritur në përfundim se: Paditësi Nj.Sh. si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka pësuar lëndime të cilat karakterizohen si „Lëndime të lehta trupore,, Ka pasur dhimbje të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 15 ditë deri në fillimin e konsolidimit të tyre si dhe të fazës së absorbimit të gjakmbledhjes rreth indeve dhe rifillimit të konsolidimit të indeve të buta dhe dhimbje të intensitetit të lehtë të cilat kanë zgjatur 25 ditë, zvogëlim të aktivitetit trupor nuk ka, as shëmtim, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 21 ditë nga dita e lëndimit ushqim të pasur me proteina, vitamina, minerale dhe karbohidrate. Po ashtu është theksuar se paditësi ka pasur nevojë edhe për kujdes nga peroni i tretë për 15 ditë dhe ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterik për 12 ditë në ndonjërin nga banjat e vendit apo fizioterapisë të cilat ndihmojnë në kthimin e lëvizjeve në normalitet.

Sipas ekspertizës së ortopedisë në fq. e fundit, te vërejtjet thuhet se: Raportet (Nj.Sh.) nga Specialisti i Plastikës, MRI e Toraxit dhe abdomenit janë pas 1.5 viti nga aksidenti, nuk kanë lidhje kauzale me aksidentin, poashtu mendojmë se edhe problemet me veshin nuk lidhen me aksidentin.

Sa i përket raportit nga eksperti specialist i psikiatrisë është konstatuar se paditësi Nj.Sh. ka pësuar me rastin e aksidentit frikë primare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur disa minuta deri në 1 (një) orë. Pastaj ka pasur edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur rreth 12 orë, pastaj frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth një muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila vazhdon të jetë prezentë edhe tani sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Lidhur me paditësen M.Sh. në ekspertizë mjekësore është konstatuar se paditësja M.Sh. si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka pësuar lëndime të cilat karakterizohen si „Lëndime të lehta trupore,, Ka pasur dhimbje të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 12 ditë deri në fillimin e konsolidimit të tyre si dhe të fazës së absorbimit të gjakmbledhjes rreth indeve dhe rifillimit të konsolidimit të indeve të buta dhe dhimbje të intensitetit të lehtë të cilat kanë zgjatur 21 ditë, zvogëlim të aktivitetit trupor nuk ka, as shëmtim. Në ekspertizë mjekësore është theksuar se paditësja M.Sh. ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 14 ditë nga dita e lëndimit ushqim të pasur me proteina, vitamina, minerale dhe karbohidrate. Po ashtu është theksuar se paditësi ka pasur nevojë edhe për kujdes nga personi i tretë për 10 ditë dhe ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterik për 10 ditë në ndonjërin nga banjat e vendit apo fizioterapisë të cilat ndihmojnë në kthimin e lëvizjeve në normalitet.

Sa i përket raportit nga eksperti specialist i psikiatrisë është konstatuar se paditësja M.Sh. ka pësuar me rastin e aksidentit frikë primare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur disa minuta deri në 1 (një) orë. Pastaj ka pasur edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur rreth 24 orë, pastaj frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth 14 ditë dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila vazhdon të jetë prezentë edhe tani sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Gjykata me aktvendim ka caktuar plotësimin e ekspertizës nga mjeku ortoped i cili ka pasur për detyrë që të plotësoj ekspertizën me të dhëna të sakta se shpenzimet e mjekimit a i përgjigjen faturat e paraqitura në shkresat e lënës. Më datë 13.03.2024 gjykata ka pranuar plotësim ekspertizën në të cilën është theksuar se në relacion me paditësen M.Sh. faturat dhe shpenzimet në fjalë pranohen si të mirëqena edhe pse ato të hipertensionit dhe koronarografi së nuk janë 100% me lidhje kauzale me aksidentin sepse e njëjta ka pasur probleme edhe më herët me hipertensionin arterial por se sa mund të jetë përqindja e ndikimit të aksidentit në pjesëmarrjen

e hipertensionit është gati e pamundur për tu precizuar andaj i pranojmë si të mirëqena. Në relacion me paditësin Nj.Sh. në plotësim ekspertizë eksperti ortoped ka theksuar se pranohen të gjithë kuponat fiskal me tik –W- dhe firmën time dhe refuzohen ato me X. Nuk pranohen kuponat e karburantit, për certifikatën mjekësore dhe ndonjë paragon. Ndërsa sa i përket kuponëve fiskal të bashkangjitur si fotokopje nuk mund të verifikohen nëse janë për të njëjtin person apo jo dhe si të tilla nuk merren parasysh. Gjithashtu i ka qëndruar në tërësi mendimit të cekur në ekspertizë tek nënvizimi vërejtje. Gjykata këtij plotësimi të ekspertizës ja ka falur në tërësi besimin dhe mbi këtë bazë edhe ka vendosur në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pika c) lidhur me shpenzimet e mjekimit-shërimit, duke u bazuar në faturat që gjinden në shkresat e lëndës.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Gjykata, në këtë procedurë ka gjetur ndërmjet ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesë padisë, por vetëm lartësia e kompensimit të kërkesëpadisë për të dy paditësit.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 159, 169, 173, 174, 179, dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimin e ekspertizës së ekspertëve Dr. H.G. Ortoped-Traumatolog dhe F.G. psikiatër, të cilat ekspertiza ndërlidhen njëra me tjetrën andaj gjykata ia ka falur besimin në tërësi si të plotë, profesionale dhe objektive.

Në rastin konkret, në bazë të gjitha provave të administruara, e në kuptim të dispozitave të lartëcekura, rezulton se paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit, kanë pësuar dëm jo material (i cili konsiston në dhimbje fizike dhe frikë), si dhe dëm material, (i cili konsiston në nevojën për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar dhe shpenzime të shërimit, ushqim të përforcuar, ndihmë nga personi i tretë). Kategoritë e lartëcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuar në ekspertizën mjekësore, të punuar nga ekspertët. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqës në seancën e shqyrtimit kryesor përveç shpenzimeve të shërimit të cilat janë konstatuar në ekspertizë se nuk kanë të bëjnë me shpenzimet e shërimit lidhur me aksidentin e ndodhur të cilat përfaqësuesi i paditësve ia ka lënë gjykatës që të vendosë nëse do i përfshijë këto shpenzime apo jo. Mbi këtë bazë, Gjykata ekspertizave në fjalë ia fali besimin e plotë, për



faktin se janë përpiluar në mënyrë profesionale dhe mbi bazën e vlerësimit të parametrave të nevojshëm në drejtim të sqarimit të rrethanave vendimtare sa i përket vendosjes së kësaj çështje. Krahas vërtetimit të faktit se paditësi ka pësuar format e lartëcekura të dëmit, buron edhe detyrimi i të paditurës për shpërblimin e të njëjtit. Bazuar në natyrën e dëmit të pësuar, rivendosja e gjendjes së mëparshme për paditësin është e pamundur, andaj shpërblimi i dëmit mund të realizohet përmes caktimit të detyrimit të paditurit për pagesën e një shume të hollave.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku për paditësin Nj.Sh. në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike të përjetuara ta detyrojë të paditurën që paditësit Nj.Sh. që t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,800€, duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore e lartë theksuar ndërsa paditëses M.Sh. që t'ia paguajë shumën prej 1,500€, duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore të lartë theksuar.

Në emër të dëmit jo material për frikën e përjetuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit Nj.Sh. shumën prej 1,000 €, po ashtu duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti, të specifikuar në ekspertizën mjekësore dhe për paditësen M.Sh. shumën prej 1000€ duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti të specifikuar në ekspertizën mjekësore psikiatrike.

Lidhur me shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, 41/2023, të dt. 27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kriteret orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, andaj shumat e gjykuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktgjykimi janë vlerësuar sipas kësaj llogaritje.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ndihmës së personit të tretë, t'ia paguajë paditësit Nj.Sh. shumën prej 150,00€ (10€ x 15 ditë) dhe për paditësen M.Sh. shumën prej 100,00€ (10€ x 10 ditë), duke marrë për bazë se nga ekspertizat mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën ditore të cekur, konform nenit 323 të LPK.

Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit Nj.Sh. shumën prej 210.00€ (10€ x 21 ditë) dhe paditëses M.Sh. shumën prej 140€ (10€

x 14 ditë), marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësi si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditë përkatësisht për 14 ditë, konform nenit 323 të LPK. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (ndihma e personit të tretë dhe nevoja për ushqim të përforcuar), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkaktimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirë për tu argumentuar nga ana e paditësit lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit.

Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke gjykuar shumat e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin material të pësuar, shumat e tilla janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të dëmtuarve - këtu paditësve në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi.

Sa i përket dëmit jo material, Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që i është bërë paditësve, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim se kompensimi i gjykuar nuk guxon të paraqet qëllime lukrative (fitimprurëse). Njëherit me rastin e caktimit të shumave të gjykuara Gjykata ka marrë për bazë karakteristikat personale të paditësve si dhe këto shuma i ka bazuar në praktikën e gjykatave në Kosovë, lidhur me caktimin e lartësisë për dëmin jo material dhe material.

Gjykata në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve përtej shumave të gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditësve në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkaktimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirat që i janë cenuar.

Gjykata e ka detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguajë paditësve së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.28.04.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. E jo siç e kanë kërkuar paditësit nga data e paraqitjes së kërkesës jashtëgjyqësore për dëmshpërblim të e paditura me dt. 03.03.2022 sepse nuk gjen mbështetje në dispozitat e LMD dhe në Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së. Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV dhe XV të këtij Mendimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika III. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 452, 453, lidhur me nenin 463.1 të LPK, duke e obliguar të paditurën që paditësve, t'ua kompensojë shumën e shpenzimeve të nevojshme dhe të domosdoshme të krijuara deri në këtë fazë të procedurës sipas kërkesës së specifikuar në vlerë të përgjithshme prej 1,467.6€ dhe atë: shumën prej 156,00€ në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 100.00 € në emër të taksës gjyqësore për padi, shumën prej 400,00 € në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizave mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë, si dhe shumën prej 608.8€ për përfaqësim në tri seanca gjyqësore të mbajtura (202.8 x 3), seanca e dt. 20.09.2023 dhe 20.02.2024 e shtyrë pa fajin e paditësve shuma prej  $101.4 \times 2 \text{ €} = 202.8\text{€}$ , ndërsa refuzohet kërkesa lidhur me kompensimin e parashtresës për precizim të padisë sepse nuk hyn në grupin e parashtresave për të cilat paguhet kompensimi. Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrave tarifor 6 dhe 7) si dhe Udhëzimit Administrativ të KGJK lidhur me Unifikimin e Taksave Gjyqësore i dt. 22.03.2017. Ndërsa kërkesa për kompensimin e shpenzimeve përtej shumës së aprovuar, refuzohet si të pabazuar.

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Datë 26.06.2024**

**G j y q t a r i,**  
**Armend Ahmeti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.